РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
ОСНОВЕН СУД СТРУГА
СУ-04.бр. 51/19-2
12.12.2019 година
С т р у г а

**ДО**

**Дневен весник КОХА -Скопје**

**Предмет:** Барање за објавување на оглас

За потребите на Основен суд Струга, бараме да го објавите огласот за вработување во следниот број.

По приемот на овој е маил ве молам да не известите по електронски пат.

Во врска со плаќањето на објавениот оглас ве известуваме дека истото ќе го направиме по испоставена фактура од ваша страна.

Со почит.

Претседател на судот
Ифет Бајрамоски

REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
GJYKATA THEMELORE STRUGË
SU-04.nr.51/19
12.12.2019
S t r u g ë

Në bazë të nenit 17 paragrafi 1, nenit 20 paragrafi 1 alineja 1 dhe nenit 25 nga Ligji për Nëpunësit Gjyqësor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 43/14, 98/15, 33/15, 06/16 dhe 198/18) dhe Rregullores për formën dhe përmbajtjen e shpalljes publike, formën, përmbajtjen dhe mënyrën e parashtrimit të fletëparaqitjes, të zbatimit të selektimit administrativ të provimeve, kontrollit të besueshmërisë së dëshmive dhe intervistës si dhe mënyra e vlerësimit të tyre dhe numri maksimal i pikëve në procedurën e selektimit në varshmëri nga kategoritë e vendeve të punës si dhe çështje të tjera me procedurën për punësim të nënpunësve gjyqësor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 236/18), GJYKATA THEMELORE STRUGË, më datë 12.12.2019

***P u b l i k o n***

**SHPALLJE PUBLIKE NUMËR - 3/2019**

**për punësim të 1 (një) nëpunsit gjyqësor në kohë të pacaktuar,**
**për vendin e punës si në vijim:**

1. **Kategorija G, niveli G3, Referent – koordinator për mirëmbajtje teknike 1 – (një) realizues – shifra SUD 0101G03002;**

Kushtet e veçanta
-Më së paku shkollim i lartë apo shkollim i mesëm
-Më së paku 1 vit përvojë pune në profesion
-Njohje aktive të njërës nga tre gjuhët më shpesh të përdorura në Unionin Europian (anglisht, frangjisht ose gjermanisht) dhe
-Njohja aktive të programeve kompjuteristike për punë në zyrë

Krahas kushteve të veçanta të theksuara, të parapara me Rregulloren për sistematizim dhe organizimin e brendshëm të vendeve të punës në Gjykatën Themelore Strugë, kandidati duhet t'i plotësojë edhe kushtet e përgjithshme, të përcaktuara në nenin 21 paragrafi 1 nga Ligji për Nëpunsa Gjyqësor, edhe atë:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut (nënshtetësija),
- në mënyrë aktive ta përdorë gjuhën maqedonase,
- të jetë i moshës madhore,
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës (vërtetim mjekësor) dhe

- me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ose ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose obligimeve (vërtetim nga gjykata).

Kohëzgjatja ditore e punës është 8 orë prej orës 07:30 deri në ora 15:30, kohëzgjatja javore 40 orë – nga e hëna në të premte; rroga bazë neto për vendin e theksuar të punës është: 17.257,00 denarë, kohëzgjatja e marëdhënies së punës është në kohë të pacaktuar.

Kandidatët janë të detyruar të parashtrojnë fletëparaqitje për punësim dhe dëshmi për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe të veçanta për vendin e punës në origjinal apo kopje të vërtetuara në Noter.

Në fletëparaqitjen, përkrah dëshmive, detyrimisht duhet të përmbahet: emri dhe mbiemri i kandidatit të mbështetura me dëshmi – letërnjoftim, vendbanimi, përkatësisht vendqëndrimi i kandidatit, e-mail adresa ose telefoni për kontakt.

Afati për paraqitje është 15 (pesëmb[dhjetë) ditë nga dita e shpalljes në gazetat ditore.

Kushtet e theksuara në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e paraqitjes.

Kandidati i cili ka dhënë të dhëna të rrejshme në fletëparaqitje diskualifikohet nga procedura e mëtutjeshme.

Fletëparaqitjen me dëshmitë, kandidatët janë të detyruar që t'a dorëzojnë drejtpërsëdrejti apo nëpërmjet postës deri në arhivin e Gjykatës Themelore Strugë, Rr. "JNA" pn, e njëjta mund të gjendet në mënyrë elektronike në internet faqen www.osstruga.mk apo të tërhiqet personalisht në hapsirat e gjykatës.

Koha dhe data e mbajtjes së seleksionimit administrativ, provimit dhe intervistës do të shpallen në internet faqen e Gjykatës Themelore Strugë.

**Kryetar i Gjykatës**
Ifet Bajramoski